

SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-153/2014

Prishtinë  
4 Maj 2016

Në çështjen juridike të:

**R. A.**

*Pala ankuese*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Syleman Nuredini, si kryetar i kolegjit, gjyqtarët e EULEX-it Anders Cedhagen dhe Beshir Islami anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/223/2013 të datës 27 nëntor 2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA28813), pas shqyrtimit të mbajtur më 4 Maj 2016, mori këtë:

## AKTGJYKIM

**Ankesa e paraqitur nga R.A., kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/223/2013, në lidhje me lëndën e regjistruar në AKP me numër KPA28813, të datës 27 nëntor 2013, hedhet poshtë si e paafatshme.**

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 5 qershor 2007, R. A. (tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (tani e tutje: AKP), me të cilën ka kërkuar ri-posedimin mbi apartamentin që gjendet në rrugën “Jovan Djordjevic” nr.13 në Gjakovë (tani e tutje: prona e kërkuar). Në kërkesën e tij nuk ka përmendur sipërfaqen e pronës duke deklaruar datën 12 qershor 1999 si datën e humbjes së pronës.
2. Në mbështetje të kërkesës së tij në AKP ka paraqitur dokumentet në vijim:
  - Një hartë të skicuar në dorëshkrim
3. Në bazë të shënimeve të AKP-së pala ankuese është kontaktuar me kërkesë të dorëzohë dokumentacion shtesë për të dëshmuar pronësinë e tij të pretenduar. Pala ankuese nuk ka dorëzuar asnjë dokument shtesë brenda afatit të dhënë.
4. Më 14 shkurt 2008, AKP-ja ka bërë njoftimin e kërkesës. Prona është gjetur e zaptuar nga Ramë Sadik Gashi (tani e tutje: pala përgjegjëse në ankesë), i cili ishte i pranishëm në pronë. Pala përgjegjëse në ankesë nuk ka pretenduar në të drejtën pronësore dhe ka nënshkruar njoftimin për pjesëmarrjen në datën e njoftimit.
5. Më 27 nëntor 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (tani e tutje: KKPK), me anë të vendimit KPCC/D/R/223/2013 ka refuzuar kërkesën. Në arsyetimin e vendimit (paragrafi 32), KKPK-ja nënvizoi se pala ankuese nuk ka arritur të dorëzohë asnjë dëshmi që Sekretariati Ekzekutiv të mund ta vërtetojë, se bartësi i pretenduar i të drejtës pronësore gëzon të drejtën mbi pronën e kërkuar.
6. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 24 shkurt 2014. Më 14 prill 2014 pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së.

### Pretendimet e palës ankuese

7. Pala ankuese me ankesën e tij kërkon nga Gjykata Supreme ta anulojë vendimin e KKPK-së pasi është i paligjshëm dhe përbën shkelje të rregullave të procedurës, ose ta ndryshojë vendimin dhe ta lëshojë një vendim tjetër të bazuar në gjendje të vërtetuar faktike. Pala ankuese po ashtu ka kërkuar nga gjykata ta sjell vendimin e vitit 1969, mbi bazën e të cilit ai pretendon se prona e kërkuar iu ishte ndarë atij

### **Arsyetimi ligjor**

8. Ankesa është e paafatshme. Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshëm private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (tani e tutje: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50) përcakton si në vijim: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”*.
9. Pala ankuese ka pranuar vendimin e KKPK-së më 24 shkurt 2014. Pala ankuese ka paraqitur ankesë vetëm më 14 prill 2014, që do të thotë se ankesa është paraqitur pas afatit kohor të përcaktuar me ligj. Pala ankuese nuk ka ofruar asnjë arsye për paraqitjen e ankesës me vonesë dhe gjykata nuk mund të vërejë ndonjë arsye për vonesën.
10. Prandaj ankesa hedhet poshtë si e papranueshme mbi bazë procedurale sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50. Si rrjedhojë Gjykata Supreme nuk mund t'i shqyrtojë bazat ligjore të treguara në ankesë.

### **Këshillë juridike**

Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, kryetar i kolegjit**

**Beshir Islami, gjyqtar**

**Anders Cedhagen, gjyqtar e EULEX-it**

**Sandra Gudaityte, referente e EULEX-it**

